

17.07.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Riparim -mirëmbajtje e dyerve eletrike për QSUNT, për 24 muaj.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 50000000-5
Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi;

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,509,007.55 (shtatë milionë e pesëqind e nëntë mijë e shtatë pikë pesëdhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke

vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % e vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar, 3 (tre) punonjës të punësuar për realizimin e kontratës/ave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Elektrik/Elektronik
- 1 (një) Punonjës Elektricitist/Elektronike
- 1 (një) Punonjës Mekanik/ Elektromekanike

Për punonjësit e kërkuar me lart, duhet të paraqiten dokumentat:

a) Për Inxhinierin Elektrik/Elektronik

- kontratë pune të vlefshme,
- diplomë përkatëse

b) Për punonjësit Elektricitist/Elektronike dhe Mekanik/ Elektromekanike

- kontratë pune të vlefshme,

- dokument që vërteton aftësinë profesionale të kërkuar në këtë kriter (i vlefshëm)

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, mund të kërkojë listën e personelit kryesor dhe fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Kriteret duhet të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Referuar Relacionit nr. 1502/8 prot., datë 29.05.2026, mbi argumentimin dhe vlerësimin e nevojave, hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën me objekt “Riparim–mirëmbajtje e dyerve elektrike të QSUNT-së, për 24 muaj”, funksionimi normal dhe i pandërprerë i infrastrukturës teknike spitalore është i domosdoshëm për garantimin e vijueshmërisë së shërbimeve shëndetësore, sigurisë së pacientëve dhe personelit, si dhe respektimin e standardeve teknike dhe të sigurisë.

Për shkak se shërbimet objekt prokurimi përfshijnë diagnostikimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e pjesëve elektrike, elektronike, mekanike dhe elektromekanike të dyerve elektrike, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë personel me profile profesionale të ndryshme dhe plotësuese. Inxhinieri Elektrik/Elektronik është i nevojshëm për diagnostikimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin teknik të ndërhyrjeve; punonjësi Elektracist/Elektronik për kryerjen e kontrolleve, matjeve, lidhjeve dhe riparimeve elektrike ose elektronike; ndërsa punonjësi Mekanik/Elektromekanik për ndërhyrjet në motorë, mekanizma, shina, rula dhe elemente të tjera mekanike ose elektromekanike.

Kërkesa për 3 (tre) punonjës përbën kapacitetin minimal të nevojshëm për ndarjen e detyrave sipas profileve përkatëse dhe për realizimin me cilësi, siguri dhe brenda afateve të shërbimeve gjatë periudhës 24-mujore të Marrëveshjes Kuadër. Kontratat e punës, diploma dhe dokumentet e aftësisë profesionale kërkohen për të vërtetuar disponueshmërinë reale dhe kualifikimin e personelit që do të angazhohet në zbatimin e kontratës/kontratave. Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcional me natyrën dhe kohëzgjatjen e shërbimit dhe nuk vendos kërkesa që tejkalojnë kapacitetin minimal të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

- 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se pjesët e zëvendësuara gjatë zbatimit të kontratës do të jenë të reja dhe do të mbulohen me garanci, sipas kushteve dhe afatit të përcaktuar nga prodhuesi ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Në bazë të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 41, pikat 1 dhe 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat teknike dhe kushtet e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit, në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës.

Referuar Relacionit nr. 1502/8 prot., datë 29.05.2026, për procedurën me objekt “Riparim–mirëmbajtje e dyerve elektrike të QSUNT-së, për 24 muaj”, kërkesa që pjesët e zëvendësuara të jenë të reja dhe të mbulohen me garanci synon të garantojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve, funksionimin e sigurt dhe të pandërprerë të dyerve elektrike, si dhe shmangien e përdorimit të pjesëve të përdorura, të rikondicionuara ose pa mbulim garancie.

Garancia sipas kushteve dhe afatit të përcaktuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij siguron që, në rast defekti të pjesës së instaluar gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik të kryejë riparimin ose zëvendësimin përkatës pa kosto shtesë për autoritetin kontraktor. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe mbron interesin ekonomik dhe funksional të autoritetit kontraktor.

- 2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

SSH/UNI/DIN/EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1, shkronja “a”, dhe nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Certifikata **SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001**, ose ekuivalente, kërkohet për të vërtetuar se operatori ekonomik zbaton një sistem të menaxhimit të cilësisë, nëpërmjet të cilit sigurohet organizimi, kontrolli dhe gjurmueshmëria e proceseve të punës gjatë realizimit të kontratës.

Certifikata **SSH/UNI/DIN/EN ISO 45001**, ose ekuivalente, kërkohet për të vërtetuar se operatori ekonomik zbaton një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, duke administruar rreziqet që lidhen me kryerjen e ndërhyrjeve elektrike, elektronike, mekanike dhe elektromekanike.

Kërkesa që certifikatat të jenë të vlefshme, të përfshijnë objektin e prokurimit dhe të jenë lëshuar nga organe të akredituara të vlerësimit të konformitetit synon të garantojë besueshmërinë dhe verifikueshmërinë e tyre. Pranimi i certifikatave ekuivalente ose të barasvlershme siguron respektimin e parimeve të konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara sh.a. nga autoriteti kontraktor “Qendra Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’”, për nevojat e të cilit Operatori i Blerjeve të Përqendruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës, kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 531, datë 07.09.2023, “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore ‘Operatori i Blerjeve të Përqendruara’ sh.a., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë”, e ndryshuar.

Dokumentacioni është hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr. 419, protokolluar me nr. 1502/1 prot., datë 24.04.2026, i ndryshuar me Urdhrin nr. 514, protokolluar me nr. 1502/3 prot., datë 15.05.2026, dhe është përcjellë me relacionin nr. 1502/8 prot., datë 29.05.2026, me lëndë: “Argumentimi dhe vlerësimi i nevojave, hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit, për procedurën e prokurimit me objekt: ‘Riparim–mirëmbajtje e dyerve elektrike të QSUNT-së, për 24 muaj’”.

Në dokumentacionin e përcjellë nga AK, grupi i punës shprehet se funksionimi normal dhe i pandërprerë i infrastrukturës teknike spitalore është element thelbësor për garantimin e vijueshmërisë së shërbimeve shëndetësore, sigurisë së pacientëve dhe personelit, si dhe respektimin e standardeve teknike, higjieno-sanitare dhe të sigurisë. Sistemet e dyerve elektrike të instaluara në ambientet e QSUT-së përbëjnë një komponent me rëndësi kritike, pasi sigurojnë

kontrollin dhe menaxhimin e fluksit të pacientëve, personelit dhe vizitorëve, aksesin e kontrolluar në ambientet e klasifikuara, ruajtjen e kushteve sterile në sallat operatore dhe repartet kritike, funksionimin e sigurt të hyrje-daljeve emergjente, mbrojtjen dhe izolimin e ambienteve me rrezatim, minimizimin e kontaktit fizik dhe të rrezikut të infeksioneve spitalore, si dhe aksesin e përshtatshëm për pacientët me lëvizshmëri të kufizuar dhe transportin e pajisjeve mjekësore.

Për shkak të përdorimit intensiv 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, si dhe kompleksitetit teknik të sistemeve automatike, mekanike dhe elektronike, këto pajisje janë subjekt i konsumimit të vazhdueshëm dhe defekteve teknike, të cilat kërkojnë ndërhyrje të specializuara parandaluese dhe korrigjuese. Mosrealizimi në kohë i mirëmbajtjes dhe riparimit mund të shkaktojë bllokimin ose mosfunksionimin e hyrje-daljeve në ambientet kritike, ndërprerjen e aktivitetit mjekësor dhe kirurgjikal, cenimin e kushteve të sterilitetit, rritjen e rrezikut për infeksione spitalore, cenimin e sigurisë në ambientet e radioterapisë dhe fizikës bërthamore, dëmtimin e mëtejshëm të komponentëve, rritjen e kostove të riparimit dhe cenimin e kushteve të sigurisë dhe evakuimit emergjent.

*Grupi i punës ka azhornuar inventarin teknik, nga i cili rezultojnë gjithsej **72 dyer elektrike automatike**, përkatësisht: 18 dyer automatike rrëshqitëse xhami për hyrjet kryesore; 8 dyer automatike rrëshqitëse xhami për boxet e reanimacionit; 2 dyer automatike me kapak për ambiente hyrëse të brendshme; 27 dyer automatike rrëshqitëse çelik-inox për sallat e operacionit; 13 dyer të plumbuara rrëshqitëse për ambientet e radioterapisë dhe fizikës bërthamore; 2 dyer bunker me kapak për akselerator dhe 2 dyer bunker rrëshqitëse për akselerator.*

Vlerësimi i nevojave dhe hartimi i specifikimeve teknike janë mbështetur në inventarin real të dyerve, tipologjinë dhe kompleksitetin teknik të sistemeve, historikun e defekteve dhe ndërhyrjeve, vitin e prodhimit, amortizimin dhe konsumimin faktik, kërkesat e sigurisë për ambientet kritike, funksionimin 24/7 të QSUT-së, intensitetin e përdorimit, si dhe kërkesat e Standardit Evropian EN 16005 për sigurinë në përdorimin e dyerve automatike.

Në këtë kuadër, është vlerësuar e nevojshme kryerja e mirëmbajtjes parandaluese me kontrolle periodike, mirëmbajtjes korrigjuese me shërbime riparimi, furnizimit dhe vendosjes së pjesëve të këmbimit të dëmtuara, testeve pas ndërhyrjeve, si dhe ofrimit të shërbimit emergjent me gatishmëri të asistencës teknike 24/7, për një periudhë 24-mujore.

NJESIA E PROKURIMIT: